



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe EC MA
NDARYSHE

THIRRJE PËR OFERTË

Hartim/zhvillim per Manual mbi procedurat standarde për lëshimin e lejes mjedisore komunale për ndërtesat kolektive të banimit

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTS", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **"Hartimin/zhvillimin e Manualit mbi procedurat standarde për lëshimin e lejes mjedisore komunale për ndërtesat kolektive të banimit"**.

Dokumenti duhet të përmbajë analizë të thellë të gjendjes së procedurave të lëshimit të lejeve mjedisore në komuna duke përfshirë analizën e legjislacionit, strategjive dhe dokumenteve tjera relevante në nivel qendror dhe lokal. Qëllimi i kësaj analize është identifikimi i problemeve, vështirësive dhe nevojave të komunave në këtë aspekt edhe rekomandimet e përkthimi i tyre në mjete/instrumente (manualë) përmes të cilëve do të përmirësohej rrjedha e punës në komuna sa i përket lëshimit të lejes mjedisore dhe mbikqyrjes së zbatimit të tyre.

Përmes manualit pritet të ndikohet në përmirësimin e rrjedhës së punës në sektorin për mjedis dhe krijimin e procedurave standarde për lëshimin e lejes mjedisore komunale për ndërtesat kolektive të banimit gjë që do të lehtësonte procesin e vendimmarrjes nga ana e Komunës. Gjatë hartimit/zhvillimit të hulumtimit/analizës, pala e angazhuar duhet të organizoj takime me përfaqësues të komunës/drejtorive përkatëse për t'i njoftuar për qëllimin e analizës/hulumtimit; të organizoj takime me njohës të fushave dhe palë tjera të interesit.

Afati për përfundim të dokumentit:

24 qershor 2022

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit;
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtë të metodologjisë së hulumtimit/analizës duke ofruar së paku informata mbi dokumentacionin që do të analizohet, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të dokumentit. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më 29.04.2022 , ora 15:00 me shënim: ***“Hartimi i Manualit mbi procedurat standarde për lëshimin e lejes mjedisore komunale për ndërtesat kolektive të banimit”***. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më 25.04.2022

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.